



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDIERËN ZNJ. MBARIME  
HOXHA**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga **Z. Tomor Hoxha**, Nr. 6191 prot, datë 18.11.2024, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitare e rezidenciale, kriteret procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e tyre për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

**JU RELATOI:**

Të nderuar këshilltarë!

Familja Hoxha jetonë në lagjjen nr. 3, “Donika Kastrioti”, rruga “Kondas”, në një banesë private. Gjatë verifikimit në regjistrin kombëtar të gjendjes civile rezulton që kjo familje ishe e përbërë nga dy antarë, bashkëshorti z. Tomor Hoxha dhe e ndiera znj Mbarime Hoxha. Bazuar në kërkesën e bërë nga bashkëshorti z. Tomor Hoxha lidhur me pa mundësin financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit, pasi u administrua kjo kërkesë nga drejtoria e Shërbimit Social nëpërmjet skuadrave të terrenit ju bë vlerësimi social-ekonomik.

Gjatë vlersimit social-ekonomik rezulton që kjo familje jetonë në një banesë të tipologjisë gasoniere me orëndi të vjetëruara dhe me hapsira minimale. Të ardhurat e kësaj familje është vetem pension i z. Tomor në shumën 21.552 (njëzetë e një mijë e pesëdhjetë e dy) lekë si invalid. Z. Tomor ka lindur sordomutant dhe nga ky problem shëndetësor është aksidentuar dhe ka pësuar thyerje të kafës (comocion cerebral). Kjo familje ndër vite ka pasur



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

probleme të dukshme social-ekonomike por dhe shëndetësore që i kanë penguar të kryejnë një stil jete normal dhe të përballojnë shpenzimet familjare. Për të mos mjaftuar problemet e kryefamiljrit me shëndetin në vitin 2023 e ndiera znj. Mbarime Hoxha diagnostikohet me probleme të theksuara kardiologjike. Si pasojë e këtyre problemeve znj. Mbarime i nështrohet ndërhyrjes kardiologjike. Në muajet në vazhdim sëmundja e znj. Mbarime kishe një regres të dukshëm dhe në datë 31.10.2024 znj. Mbarime Hoxha ndëroj jetë me shkakun (ruptur të micardos), çarje të cipës së zemrës. E ndiera ndëroje jetë në Qendrën Spitalore Nënë Tereza Tiranë. I gjendur në këto kushte dhe në pa mundësi për të përballuar shpenzimet e varrimit z. Tomor Hoxha i drejtohet bashkisë Berat dhe Shërbimit Social për ti mundësuar vetëm shpenzimet e varrimit.

Duke u bazuar në historikun e familjes dhe në vlerësimin socio-ekonomik, pamundësive financiare dhe shëndetësore për të përballuar shpenzimet e varrimit, kërkesës së paraqitur nga bashkëshorti Z.Tomor Hoxha, drejtorja e Shërbimit Social, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Bashkangjitur gjeni:

- 1.Aktin e vdekjes.
- 2.Fotokopjet e karës të z. Tomor Hoxha.
3. Çertifikat familjare aktuale.
- 4.Kërkesa e Z. Tomor Hoxha.
5. Vertetim mbi përfitimin e statusit të invalidit dhe të ardhurat.
- 6.Faturë tatimore nga subjekti AB.ZOGA SH.P.K.
- 7.Korespodenca me Shërbimin Social.

**DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL**

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDIERËN ZNJ. ANETA NIJA**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga **Z.Filip Nija**, Nr. 2510 prot, datë 25.01.2024, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitare e rezidenciale, kriteret procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e tyre për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

**JU RELATOI:**

Të nderuar këshilltarë!

E ndiera **znj. Aneta Nija** jetonte në adresën: Lagjja nr. 2, “Goricë”, rruga “Kristaq Tutulani”, pallati 2-katësh. Znj. Aneta në këtë banesa jetonte e vetme dhe pa mbështetje kjo e verifikuar dhe nga strukturat e shërbimit social, skuadrat e terrenit, pasi kohët e fundit znj. Nija shpesh herë paraqitesh pranë bashkisë Berat duke shfaqur problematika të ndryshme si pasojë e moshës së madhe (dyshuar dhe për demenca senile). Nga muaji janar 2024 deri në muajin korrik 2024 (ku ndëroj dhe jetë), e ndjera znj. Nija vuante nga probleme të theksuara kardiologjike. Në datën 19.07.2024 ajo ndërojn jetë me diagnozën (IKK), insufiçenc kardiake kronologjike. Nga verifikimet e bëra në regjistrin kombëtar të gjendjes civile rezulton që znj. Nija ishte e vetme në trugun familjar (beqare) dhe nuk kishte krijuar familje. Muajet e fundit për të ndierën u kujdes i vllai z. Filip Nija pensionit 78 vjeç. Momentin që ndëroj jetë Z. Filip u paraqit pranë bashkisë Berat, drejtorisë së Shërbimit Social duke kërkuar mbështetje finaciare për shpenzimet e varrimit pasi e kishte të pa mundur ti përballonte vetëm me pensionin e tij këto shpenzime. Pas komunikimeve me z. Filip verifikimeve që realizuan strukturat e Shërbimit Social e ndiera Znj. Aneta Nija u varros ditën që humbi jetë, duke mos bërë ceremoni mortore sipas zakoneve dhe





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

kulturës Shqipëtare kjo nga gjithë dinamika e problemeve që kishte familja Nija.

Duke u bazuar në historikun e familjes dhe në vlerësimin socio-ekonomik, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit, kërkesës së paraqitur nga vllai Z.Filip Nija, drejtorja e Shërbimit Social, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Bashkangjitur gjeni:

- 1.Aktin e vdekjes.
- 2.Fotokopjet e karës të z. Filip Nija.
- 3.Kërkesa e Z. Filip Nija.
- 4.Faturë tatimore nga subjekti AB.ZOGA SH.P.K.
- 5.Korespodenca me Shërbimin Social.

**DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL**

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

**RELACION**

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA Z. LUAN KANANI**

Drejtorja e Shërbimit Social dhe Drejtorja e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga Znj.Luan Kanani, Nr. 5281 Prot, datë 04.10.2024, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitare e rezidenciale, kriteret procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e tyre për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

**JU RELATOI:**

Të nderuar këshilltarë,

**Z. Luan Kanani** jetonë në lagjen nr. 3 “Donika Kastrioti”, rruga “Lisi i Beçit”, në një banesë privat. Nga verifikimet e bëra në regjistrim kombëtar të gjendjes civile rezulton që ky shtetas është i vetëm (i pa martuar), vetëm një antar në trungun familjar. Që në moshën 17 vjeçare z. Luan merr statusin e paraplegjikut dhe për 52 vite gjendet i paralizuar në pa mundësi totale për tu kujdesur për veten. Ai jetonë në një dhomë të ofruar nga familja dhe është mbështetur tek i vllai, ku kjo familje ka dhe kujdestarin ligjore për z. Luan. Për afro gjashtë muaj këtij shtetasi është ndërprerë paketën higjienosanitare kjo si pasojë e taks-forcës. Pasi është njohur me vendimin e taks-forcës z. Luan Kanani apelon vendimin në instacën më të lartë atë të KMCAPI-t Epror dhe dosja e tij që nga muaji Mars 2024 ndodhet pranë këtij komisioni. Z. Luan ka të ardhura vetëm pagesën e statusit të paraplegjikut në shumën 12.676 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë. Mugesia e pagesës për paketën higjieno-sanitare i ka sjell vështirësi të dukshme në stilin e jetësës dhe në kujdesin personal gjë e cila e rëndonë së tepërmi situatën e tij shëndetësore, pasi me të ardhurat që ka nuk mundëson kujdesin e tij personal dhe medikamentet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

e nevojshme që duhen për këtë sëmundje. I ndodhur në këto kushte dhe në pa mundësi për të siguruar paketën higjieno-sanitare Z. Luan Kanani i drejtohet bashkisë Berat, nëpërmjet drejtorisë së Shërbimit Social për një mbështetje të përkohëshme në mënyrë që mosë përkeqësohet gjendja e tijë shëndetësore. Kjo mbështetje konsiston deri në momentin ardhjes së përgjigjes përfundimtare nga KMCAE-Epror. Menjëherë strukturat e shërbimit social realizuan vizitën social-ekonomike për z. Luan ky konstatuan situatën e sipërpërmendur dhe nevojë të menjëhershme për të pasur paketën higjieno sanitare deri në momentin e mbëritjes së vendimit nga instancat përkatëse.

Duke u bazuar në historikun e familjes dhe në vlerësimin socio-ekonomik, pamundësive financiare dhe shëndetësore për të përballuar shpenzimet lidhur me paketën higjieno-sanitare e cila i nevojitet për të përmbushur nevojat personale, kërkesës së paraqitur nga Z.Luan Kanani, drejtoria e Shërbimit Social, propozon ta mbështesë, në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Bashkëngjitur gjeni:

1. Kërkesën e z. Luan Kanani.
2. Çertifikatë familjare/ kopje të ID kartave .
3. Vërtetimi mbi masën e pagesës për aftësin e kufizuar.
4. Vendimin e KMCAE-it.

**DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

Berat, më 18.11.2024

RELACION

MIRATIMIN E PROJEKTIT “SISTEMIMI I AMBIENTEVE TË JASHTME NË SHKOLLËN 9-  
VJEÇARE “THIMI TANI”

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat ka aplikuar pranë Raiffeisen Bank dega Berat një projekt për Sistemimin e ambienteve të jashtme në shkollën 9-vjeçare “Thimi Tani” ne kuadrin e programit social te Raiffeisen Bank.

Shkolla Thimi Tani është një shkollë e rëndësishme, nisur edhe nga fakti se ndodhet në një zonë jo të favorizuar ekonomike të qytetit si dhe e cila ka një densitet të madh të komuniteteve të marginalizuara. Ajo ka në total 279 nxënës, nga të cilët 107 vajza dhe 172 djem. Është gjithashtu një shkollë me një prani të madhe të komunitetit Romë dhe Egjiptian. Në shkollë studiojnë 86 nxënës të komunitetit Romë dhe 13 nxënës të komunitetit Egjiptian. Një problem i kahershëm i shkollës është infrastruktura e dëmtuar, veçanërisht në oborrin e saj. Projekti parashikon shtrimi i oborrit me pllaka betoni, mbjellje pemësh dhe vendosja e stolave të drurit në mjediset e oborrit.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është përmirësimi i infrastrukturës arsimore, rekreative dhe sportive në shkollën “Thimi Tani”, rritja e potencialit tërheqës të shkollës për të tërhequr edhe më shumë nxënës dhe për të lehtësuar edukimin publik ndër-komunitar.

Si rrjedhojë e procedurave, është e nevojshme që projekti me vlerë 1,926,129.94 leke te reja të miratohet në parim nga Këshilli Bashkia i Bashkisë Berat

Faleminderit

KRYETARI I BASHKISË  
Ervin DEMO





3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

Berat, më \_\_\_\_\_.2024

RELACION

PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT SI KAPITAL I MJETEVE DHE PAJISJEVE NË FAVOR TË  
SHOQERISË BERAT CITY GREEN -BCG SH.A

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat është përfituese e projektit Ndarja në Burim e Mbetjeve Urbane në Bashkinë Berat. Ky projekt financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe është në partneritet me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Në kuadër të këtij projekti, Bashkia është përfituese e një metodologjie për ndarjen e mjeteve në burim, asistencës teknike për zhvillimin e kapaciteteve për menaxhimin e modelit të ri si dhe të infrastrukturës së nevojshme për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve në burim

Projekti ka dhuruar për Bashkinë Berat një listë me mjete dhe pajisje të cilat do të shërbejnë për grumbullimin e diferencuar. Lista e mjeteve është si më poshtë.

- 1- Fadrome Gunter Grossmann. Lloji i mjetit GG010. Numri i identifikimit të mjetit: 010240307
- 2- Presë, Model BTS-MF450. Forca e presimi: 50 tone. Motori 11 KW 32 AMP
- 3- Urë Peshore, Model MMTPA, 50-80 Ton. Model MMTPA 9 x3m. Peshëmatja 50-80 ton
4. 9 Tabela informuese ( etalbond, adeziv, kembe metali)
5. Kamionçinë Piaggio Porter NP6LPR Garbage Compactor – ZAPNP6c1C0P003081
6. 3 Tabela me Ndricim: Struktura metalike 120x180cm me etalbond. Ndriçim Led
7. 280 Kontenier 1 m<sup>3</sup>. Materiali Polietilen (HDPE), kundra rrezeve UV. Rezistent
8. Linjë transportuese per ndarjen e mbetjeve. Fuqia e instaluar 2.2 KW

Këto mjete nevojiten të transferohen në pronësi të Shoqerisë Berat City Green - BCG SH.A e cila është edhe ndërmarrja përkatëse që do të merret me administrimin dhe mbledhjen e diferencuar të mbetjeve. Nevojitet miratimi juaj për transferimin si kapital i mjeteve të cituara më sipër në favor të Shoqerisë Berat City Green - BCG SH.A

Faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË  
Ervin DEMO







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

RELACION

Mbi miratimin e tarifave të përdorimit me pagesë të fushave sportive Parku ‘‘Dua të Luaj’’ dhe miratimin e përdorimit të ambienteve të Parkut ‘‘Dua të Luaj’’ pa pagesë sipas kategorive të caktuara.

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.3, germa ‘‘b’’, neni 54 germa ‘‘f’’ të Ligjit nr.139/2015, ‘‘Për vetëqeverisjen vendore, ligji nr.9632, datë 30.10.2006 ‘‘Për sistemin e taksave vendore’’ i ndryshuar,ju paraqesim Relacionin ‘Mbi miratimin e tarifave të përdorimit me pagesë të fushave sportive Parku ‘‘Dua të Luaj’’ dhe miratimin e përdorimit të ambienteve të ‘‘Parkut Dua të Luaj’’,pa pagesë sipas kategorive të caktuara’’.

Projekti i Parkut ‘‘Dua të Luaj’’ është duke u përfunduar tashmë në territorin e Bashkisë Berat si nje angazhim i Bashkisë ndaj nevojave të komunitetit.

Ky investim erdhi si kërkesë e Bashkisë Berat, me financim nga Qeveria Shqiptare, nëpërmjet Fondit Shqiptar te Zhvillimit, si një nevojë për të shtuar hapësirat rekreative për fëmijë dhe të rritur.

Parku ‘‘Dua të Luaj’’ shtrihet në Rajonin nr.2, lagjia ‘‘30 vjetori’’ dhe janë ndërtuar:

- 1 fushë futbollo
- 1 fushë basketbollo
- 2 fusha volejbollo
- 1 fushë tenisi
- 2 fusha padel
- 1 kënd lojrash
- Korsi biçikletash
- Pistë vrapimi
- Zona Fit Play- Palestër e hapur

Kjo vepër është konceptuar gjithëpërfshirëse, për të gjitha grupmoshat që të kenë akses në aktivitete sportive dhe të kohës së lirë, por dhe që qyteti ynë të ketë vende ku fëmijët e shoqëruar nga familjarë mund të kalojnë kohën e tyre .

Sa më lart, Bashkia Berat do të marrë në dorëzim dhe në administrim objektin ‘‘ Parku Dua të Luaj’’.

Me qëllim disiplinimin e rezervimeve dhe menaxhimin efikas të Parkut ‘‘Dua të Luaj’’, si dhe për të patur një mirëmbajtje të duhur nga ana e konsumatorëve, Bashkia Berat propozon vendosjen e tarifave me poshtë për shfrytëzim me një pagesë simbolike të fushave sportive pranë Parkut Dua të Luaj. Theksojmë se vendosja e tarifave është karahsimisht shumë herë më e ulët se ajo e tregut privat sot dhe vendosja e tyre bëhet me qëllim që të ruhen dhe për to të kujdeset jo vetëm administrata,por dhe përdoruesit e qytetarët.

### **1.Propozojmë që të aplikohen tarifat si më poshtë për pagesë në fushat sportive:**

Fusha e futbollit	500 lekë/ora
Fusha e basketbollit	300 lekë/ora
Fusha e volejbollit	300 lekë/ora
Fusha e tenisit	300 lekë/ora
Fusha Padel	300 lekë/ora

2.Propozojmë që përdorimi i fushave sportive nga nxënësit e shkollave në funksion të misionit të shkollave të jetë pa pagesë.

3. Propozojmë që përdorimi i fushave sportive për aktivitetet e organizuara nga Bashkia Berat të jetë pa pagesë.

4.Propozojmë që aktivitetet e tjera sic janë: hyrja në Parkun Dua të Luaj, këndi i lojrave,korsia e biçikletave, pista e vrapimit dhe zona FIT Play-palestër e hapur, të jenë pa pagesë për të gjithë përdoruesit.


Personat të cilët do të zhvillojnë aktivitete sportive në fushat sportive me pagesë, do të pajisen me një biletë hyrëse e cila do menaxhohet nga struktura e Parkut ‘‘Dua të Luaj’’ pranë Bashkisë Berat. Punonjësit e këtij Parku do të presin fatura kundrejt çmimeve të mësipërme dhe do të bëjnë arkëtimet e faturave çdo të hënë.

Arkëtimi i të ardhurave do të kryhet në bankë nga mbajtësi i mandateve, në zërin ‘‘Të ardhura nga parku DUA TE LUAJ’’ sipas faturës që do të lëshohet nga specialisti i financës.

Sa më sipër i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e miratimin e tarifave të përdorimit me pagesë të fushave sportive Parku ‘‘Dua të Luaj’’, si dhe miratimin e përdorimit të ambienteve të Parkut ‘‘Dua të Luaj’’ pa pagesë sipas kategorive të caktuara.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË  
Ervin DEMO

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Ervin DEMO', written over the printed name.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

Berat, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

RELACION

MIRATIMIN E PROJEKTIT "SMART PARKING NE KALA", MIRATIMIN E AKSESIT TE BANOREVE TE KALASE PA PAGESE DHE MIRATIMIN E STRUKTURES PERKATESE TE MENAXHIMIT TE PARKIMIT DHE TRAFIKUT

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat është përfituese e projektit Smart Parking në Lagjen Kala, financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Me anë të këtij projekti do të mundësohet blerja e infrastrukturës së nevojshme për automatizimin e hyrjes së automjeteve në lagjen Kala.

Pak metra përpara hyrjes për në portën e parë të kalasë do të vendoset një barrierë parkimi e pajisur me aparatura të teknologjisë së lartë e cila do të funksionojë për të limituar trafikun në lagjen kala. Pajisja do të jetë e pajisur me kamera detektuese e cila do të lejojë kalimin vetëm të automjeteve të banorëve dhe të shërbimeve publike.

Barriera do të jetë e përbërë nga dy kolona, një kolonë hyrëse dhe një kolonë dalëse. Do të jetë e pajisur me software të posaçëm për të mundësuar operimin e përditshëm të saj.

Automjetet e banorëve dhe të shërbimeve publike bashkiake do të jenë të regjistruar në sistem dhe barrieria do të lejojë hyrjen dhe daljen e tyre në mënyrë automatike pa pagese. Njëkohësisht struktura e parkimit do të lejojë përdorimin e kartave hyrëse dhe dalëse të cilat do të mund të përdoren në raste të caktuara apo në raste emergjencash. Personat e pajisur me kartë do të kenë të drejtë të mund të kalojnë përtej sistemit të parkimit.

Për të menaxhuar sistemin e ri të parkimit të Kala është e nevojshme që të parashikohet një shtesë prej dy personash në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Berat. Personat e punësuar do të monitorojnë funksionimin e sistemit të parkimit në brendësi të lagjes kala.

Vendosja e kësaj barriere vjen si domosdoshmëri e rregullimit të trafikut në lagjen kala me shtimin e beftë të numrit të vizitorëve në dy vitet e fundit. Nevoja për kufizimin e trafikut në lagjen kala është një kërkesë e banorëve në lagje, bizneseve si dhe vetë vizitorëve. Për të marrë këtë vendim është parë edhe eksperiencia e vendeve të tjera historike në rajon dhe më gjerë. Kufizimi i trafikut do të lejojë një eksperiencë me të pasur të vizitorëve por njëkohësisht do të ndihmojë edhe banorët të mos e përjetojnë me vështirësi rritjen e vazhdueshme të numrit të vizitorëve.

Kjo masë do të dekurajojë njerëzit të udhëtojnë për në lagjen kala me automjet nëse nuk e kanë të nevojshme dhe njëkohësisht do të nxisë banorët dhe vizitorët gjithashtu të përdorin transportin publik. Gjithashtu Bashkia Berat së bashku me konsulentë vendas dhe të huaj është duke përgatitur planin e menaxhimit për të përcaktuar dhe rregulluar vend-parkimet në zonat e jashtme të lagjes Kala.

Faleminderit

KRYETARI I BASHKISË  
Ervin DEMO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

RELACION

MBI MIRATIMIN E ZONAVE TË PARKIMIT ME PAGESE, TARIFAVE TË PARKIMEVE PUBLIKE :  
“PARKIMI GORICË ” DHE “PARKIMI LINDOR I GORICËS”, SI DHE NJË SHITESË NË NUMRIN E  
PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË BERAT, PËR MENAXHIMIN E TYRE.

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat ka në pronësi dy ambiente publike pranë Urës së Goricës, “Parkimi Goricë” i cili është ndërtuar në kuadër të projektit “Rehabilitimi i siluetës urbane në lagjen Goricë” me 63 vende parkimi, gjithashtu është duke krijuar edhe Parkimin publik në pjesën lindore të Goricës (pranë restorant “Dhelpra”) me 32 vende parkimi.

1-Parkimi në Goricë deri tani ka funksionuar si parkim pa pagesë për qytetarët dhe turistët që vizitojnë qytetin. Lagja Goricë është një lagje pjesë e Ansamblit muzeal të qytetit të Beratit dhe një atraksion turistik i rëndësishëm në qytet.

Duke parë fluksin e mjeteve që mbërrin në lagje është e nevojshme që të disiplinohet ky fluks duke i dhënë prioritet qytetarëve dhe bizneseve.

2- Parkimi në pjesën lindore të Goricës do të vihet në funksion së shpejti me 32 vende parkimi.

Të dy parkimet do kenë logjistikën e nevojshme me vend –qëndrime për rojet, kolona hyrëse dhe dalje, barriera të kompjuterizuar, lexues kartash për pagesë dhe skanime barcodi.

Janë kryer dy dëgjesa publike me qytetarët , banorët e lagjes Goricë dhe Mangalem, në datat 05.08.2024 dhe 20.08.2024.

Duke studiuar me kujdes fluksin e mjeteve, lëvizjen e banorëve dhe turistëve, nevojat, kostot dhe përfitimet, ju propozojmë tarifën e mëposhtme për të dy parkimet:

Tarifat :

0 - 3 orë	100 lekë
3-6 orë	200 lekë
6-8 orë	300 lekë
8-24 orë	600 lekë

Abone mujore	2500 lekë/muaj. Nëse paguhet 6 mujore
Abone mujore	4500 lekë/muaj . Nëse paguhet 1 mujore

Për banorët rezidentë të lagjes Goricë, tarifën e aboneve mujore do jenë : 2000 lekë/muaj. Nëse paguhet 6 mujore.

Banorët e lagjes Goricë do përdorin me abone mujore, vetëm parkimin lindor të Goricës.

Për menaxhimin e Parkimeve më sipër, pas studimit të kryer mbi kostot dhe mbulimin e shërbimit të stafit të parkimeve nga pagesat e tarifave, do nevojitet një staf i përbërë nga një (1) përgjegjës dhe (4) katër punonjës, të cilët do jenë pjesë e strukturës së bashkisë Berat.

Ju propozojmë miratimin e dy vend parkimeve më sipër, të tarifave përkatëse të dy parkimeve, si dhe miratimin shtesë personeli, shtesë në numrin e përgjithshëm të punonjësve me 5 (pesë) punonjës për menaxhimin e dy parkimeve. Bazuar në përlllogaritjet e kapaciteteve të këtyre parkimeve, si dhe tarifave të propozuara, efektet financiare të kostove për pagesat e këtyre punonjësve do të mbulohen nga vetë të ardhurat e krijuara nga parkimet e propozuara.

Faleminderit

KRYETARI I BASHKISË  
Ervin DEMO

